

Krimet Naziste ndaj Shqiptarëve

PUNOI: ERA ARAPI

GJIMNAZI: SAMI FRASHËRI

KLASA: 11.5



KRIMET NAZISTE NDAJ SHQIPTARËVE

“Në Tiranë arrita në 10 korrik dhe mësova se në shtëpinë time, ishin hapur dyert e mortit për mua”¹ shkroi Beqir Xhepa, një nga të paktët të mbijetuar të kampit të përqëndrimit. Një njësi gjermane drejtuar nga Baron Maximilian von Weich pushtoi Shqipërinë me date 9 shtator 1943 dhe hasi një qëndresë të vogël nga forcat italiane dhe grupet e rezistencës. Në fillim ulën këmbë në Elbasan and Strugë, më pas në territorin midis Tepelenës dhe Vlorës, Prishtinë dhe Prizren dhe me rradhë. Ajo që nisi si një pushtim “paqësor” nuk i mbajti këto tipare. Në historinë e popullit shqiptar janë lënë mjaft plagë nga forcat naziste. Djegja e pushkatimi i fshatrave, apo dhe pas pushtimit vuajtja e individëve në kampet e përqëndrimit.

“Kur e panë që qëlluan mbi djepin, u hodh gjyshja dhe ra mbi të, pastaj gjyshi, xhaxhai dhe vetë e jemë. Ishin 4 martilë që mbuluan një foshnje.” Gjatë rrugës Korçë-Janinë, në korrik partizanët sulmuan një autokolonë gjermane prej 300 kamionësh dhe autobлиндash. Sulmi i tyre shkatërroi 1 motorçikletë dhe një pjesë të makinave. Nga ushtria gjermane mbetën të vdekur 4 ushtarë dhe 12 u plagosën. Nisur nga kjo goditje e papritur gjermanët u kundërpërgjigjën duke shkatërruar fshatin e pambrojtur dhe të pafajshëm të Borovës, duke asgjësuar 107 veta dhe plagosur 8. Një pjesë e madhe e civilëve të cilët u vranë ishin gra, fëmijë dhe foshnja. Më pas i gjithë fshati u mbulua nga flaka. 6 korriku i 1943 njihet si masakra e Borovës. Ngjara tronditëse kujtohet ende dhe pas 79 vjetësh. Çdo vit në nderim e kujtim të viktimave, në një kodër anash rrugës bëhen homazhe.² Fshati Borovës nuk ishte i vetmi që u bë pjesë e masakrave të nazistëve.

“Jetoj si kufomë, i vajtoj bashkë me juve ata burra të ndjerë!” Shprehet Mitre Carua. Shtabi partizan i krahinës porositi që të lajmëroheshin banorët e fshatrave të afërta të largoheshin nga vendbanimet e tyre në vende të fshehta larg rrezikut. Një njësi gjermane dogji Seranin, Peratin dhe u nis për në Çarshovë. Një tjetër dogji Psilloterë-Vllahun dhe Biovizhdën. Fatmirësisht banorët e këtyre fshatrave qenë larguar me kohë nga shtëpitë e tyre dhe strehuar në pyllin e Manastirit. Por njoftimet, për një arsye a një tjetër, nuk arritën kurrë në fshatrat Zhepë dhe Draçovë. Nazistët arrestuan të gjithë burrat e fshatit duke i mbledhur në një birucë. Brenda një kohe të shkurtër ata asgjësuan 28 burra³, një e nga një i pushkatuan në shesh. Banorët që shpëtuan u larguan dhe u strehuan në pyll. Të afërmit, i varrosën vetë aty ku ndërruan jetë. Darkave ata që mbjetuan rrezikonin dhe zbrisnin të korrnin grurin me të cilin ushqeheshin, duke mos pasur më dhe bagtitë të marra nga nazistët. Edhe pse shpejt forcat gjermane u larguan nga Shqipëria, çlirimi nga pushtimi 1943-1944 nuk solli qetësi për një pjesë të mirë të shqiptarëve.


“Ata që hyjnë brenda nuk dalin më jashtë” ishte parrulla shkruar në hyrje të kampit të përqëndrimit të Mauthausen.⁴ Në dimrin e viteve 1943-1944 u krye një arrestim i një numri të konsiderueshëm të shqiptarëve, në Durrës, Vlorë, në Tiranë dhe Përmet të Korçës. Rreth 500 individë⁵ u dërguan në kapet e përqëndrimit; si fillim në Jugosllavi dhe më vonë në Mauthausen pasi ishte më afër. Nazistët administronin një sistem masiv prej më shumë se 40,000 kampesh që shtriheshin në të gjithë Evropën. Numri më i madh i të burgosurve ishin hebrenj, por individë u burgosën dhe për shkak të përkatësinë etnike dhe politike. Kampet e përqëndrimit nuk ishin veçse ferri në tokë; një sistem çnjerzor krijuar vetëm për të torturuar, krijuar vuajtje dhe

asgjesuar. Të burgosurit i nënshtroheshin tmerreve që nga momenti që mbërrisin në kampe. Ata detyroheshin të zhvisheshin dhe vraponin në rreth për të kuptuar cilët mund të punonin dhe cilët duheshin asgjesuar në vend. Përgjithsisht detyrat kishin një vështirësi të madhe fizike dhe shkallë të lartë vdekshmërie; punë ndërtimi, në fabrika, miniera; dhe racionet e pakta, shtretërit e vegjël të ngjeshur, trajtimi i ashpër nga rojet, frika se mund të dërgoheshin tek krematorët, e bënë jetësën një skëterrë të pafundme.⁶

“Na pa dhe një herë, qeshi butë, përqafoi dhe vëllanë, Mehmetin. Dhe pasi na e bëri dhe një herë me dorë na tha “Mbahuni dhe mos turpëroni Shqipërinë”” Ishte një pjesë e shkruar, nga një nga shqiptarët e burgosur në kampin Mauthausen. Sundimi i forcave gjermane në Shqipëri si fillim u duk se nuk përbënte tepër rrezik, por sa më shumë shqiptaret kërkonin liri aq më të shtrënguar e mbanin litarin gjermanët. Ndaj dhe krimet e tyre kundrejt shqiptarëve janë të shumta pavarësisht sundimit afatshkurtër. Nga djegja e fshatrave, marrja e tokave dhe bagtive, pushkatimi i të pafajshmëve dhe deri tek torturat çnjerzore dhe vuajtjet në kampet e përqendrimt edhe pas çlirimit të Shqipërisë nga nazistët, paraqesin qartë krimet e tyre kundrejt popullit shqiptar.


SHTESË

1.



(Pjesë e dokumentarit "From hell to hell", Eva Kushova)

2.



(Përkujtimorja vendosur në Borovë e cila paraqet emrat e viktimave dhe imazhe të ngjarjes)(Top Channel)



(Vendi ku bëhen homazhe në nder të viktimave)

(Top Channel)

3.

“Për shkak të masakrës gjetën vdekjen 28 burra: 1-Aleks Thimjo Kosta, 2-Kiço Simo Papajorgji, 3-Mihal Thanas Bidika, 4-Dhoskë Pavli Pavli, 5-Koto Kristo Kobuzi, 6-Nini Thimio Kosta, 7-Ligor Mina Konomi, 8-Kiço Thimio Proko, 9-Petraç Josif Kovaçi, 10-Josif Ligor Zisi, 11-Myslim Osman Ahmeti, 12-Pano Petraç Kovaçi, 13-Jano Petro Saqellari, 14-Vasile Raca (u dogj) 15-Pandeli Kiço Papajorgji, 16-Kolo Stavro Bidika, 17-Leonidha Zembereku, 18-Sadik Shaqir Dede, 19-Kiço Ngjelo Prifti, 20-Ligor Petro Milo, 21-Spiro Mihal Prifti, 22-Kolo Stavro Bidika, 23-Llukan Mitre Caro, 24-Vaso Ilia Shyti, 25-Koço Taço Nika, 26-Llazo Thanas Stefani, 27-Vasil Tase Bozili, 28-Vasil Prifti”

(Vangjel Haxhi)

4.



(Hyrja në kampin e përqendrimit në Mauthausen)

(Pjesë e dokumentarit “From hell to hell” Eva Kushova)

5.

Mehmet Agalliu u nda nga jeta më 6 Qershor 1955
Stefan Konduri u nda nga jeta më 22 Gusht 1972
Ahmet Çekaj u nda nga jeta më 2 Korrik 1978
Gaqo Çomo u nda nga jeta më 31 Tetor 1986
Dhimitër Simoni u nda nga jeta më 19 Nëntor 1989
Vangjel Doni u nda nga jeta më 9 Maj 2005
Beqir Xhepa u nda nga jeta më 15 Prill 2016
Abdulla Krutani u nda nga jeta më 26 Korrik 2020

EVA KUSHOVA | IDEATORE E EKSPozITËS

TETË DËSHMITË E RRALLA

(CNN Exclusive News
Channel Affiliate)

6.



(Foto e të burgosurve në kampin e përqëndrimit)
(Pjesë e dokumentarit "From hell to hell" Eva Kushova)

Bibliografia

“Nga Ferri Në Ferr - Dokumentar/ From Hell to Hell- Documentary.” *YouTube*, 28 Dec. 2021, www.youtube.com/watch?v=IRnX8GTdHy0.

“Veteranët dhe Pasardhësit e LANÇ të Popullit Shqiptar "Nderi i Kombit"” Vangjel Haxhi,

Top Channel Sh.a. “Masakra E Borovës! Rikujtohet 79-vjetori I Vrasjes së 107 banorëve Nga Ushtria Naziste.” *Top Channel Sh.a.*, 7 July 2022, top-channel.tv/2022/07/07/masakra-e-boroves-perkujtohet-79-vjetori-i-vrasjes-se-107-banoreve-nga-ushtria-naziste.

Daily Life in the Concentration Camps — United States Holocaust Memorial Museum.
www.ushmm.org/collections/bibliography/daily-life-in-the-concentration-camps.
Accessed 3 Oct. 2022.

“Tetë Dëshmitë E Rralla, Shqiptarët E Mbijetuar Në Kampet Naziste Të Përqendrimit.”
YouTube, 26 Jan. 2022, www.youtube.com/watch?v=mOzCa_VANy8&t=581s.

Fischer, Bernd J. *Shqipëria Gjatë Luftës*. Tiranë, al, Botime Çabej MÇM.